

U D H Ë Z U E S

Mbi zhvillimin e
PLANIT TË MBËSHTETJES INDIVIDUALE
për personat me aftësi të kufizuar

UDHËZUES

**MBI ZHVILLIMIN E PLANIT TË MBËSHTETJES
INDIVIDUALE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR**



Tiranë 2025

TABELA E LËNDËS

Hyrja.....	3
Konteksti.....	4
Parimet Drejtuese.....	5
Rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve.....	6
Plani i Mbështetjes Individuale (PMI).....	8
Rishikimi, monitorimi, vlerësimi dhe përfundimi i PMI.....	9
Aneks 1.....	10
Bibliografia.....	14

HYRJA

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të përqendrohet në komponentët që kërkohen në një Plan të Mbështetjes Individuale (PMI), si edhe të ofrojë një pasqyrë të shkurtër të procesit të planifikimit me në qendër personin me aftësi të kufizuar.

PMI është një dokument planifikimi që vendos në qendër personin me aftësi të kufizuar, në përputhje me vlerësimin që është kryer nga Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (KSHVAK) dhe nevojat e individit.

PMI hartohet mes një individi, mbështetësve të tij dhe ofruesit të shërbimit që pasqyron qëllimet e personit me aftësi të kufizuara, përshkruan se si do të ofrohet mbështetje për të adresuar dhe arritur qëllimet e tyre, si edhe mënyrën se si do të maten rezultatet.

Planifikimi për personat me aftësi të kufizuar duhet të zhvillohet nëpërmjet një procesi planifikimi që adreson shërbimet dhe nevojat për mbështetje si edhe preferencat dhe qëllimet individuale të personit me aftësi të kufizuar.

Legjislacioni në fuqi kërkon që procesi i planifikimit me në qendër personin të jetë drejtuar nga vetë individi me aftësi të kufizuar ose nëpërmjet procesit të vendimmarrjes së mbështetur¹ (marrjen e vendimeve nga personi me aftësi të kufizuara pas ofrimit të informacionit të plotë nga mbështetësi).

Kërkesat minimale për PMI-të duhet të përfshijnë, qëllime dhe preferenca personale të identifikuara, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në komunitet, arsimin, aftësimin profesional, punësimin, kujdesin shëndetësor, mirëqenien, etj. Proces i planifikimit dhe vetë PMI-ja, do të ndihmojnë personin me aftësi të kufizuar në arritjen e rezultateve në mjedisin e integruar të komunitetit, do të sigurojë shpërndarjen e shërbimeve në një mënyrë që pasqyron preferencat dhe zgjedhjet personale dhe do të kontribuojë në sigurimin e shëndetit dhe mirëqenien e personit me aftësi të kufizuar.

Procesi i planifikimit me në qendër personin është mjeti me të cilin mblidhet informacioni për të krijuar një PMI. Individi do të udhëheqë procesin e planifikimit kur kjo është e mundur, ndihmësi personal / mbështetësi mund të kenë një rol pjesëmarrës, sipas nevojës, përveç rasteve kur ligji i jep autoritetin vendimmarrës përfaqësuesit ligjor.

PMI mund të përfshijë, por nuk kufizohet:

¹ “Vendimmarrje e mbështetur” është ushtrimi i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundësuar kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime. Çdo person me aftësi të kufizuara, që ka nevojë për ndihmë në vendimmarrje, merr mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar. Mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash, përfshirë mbështetjen me anë të interpretimit dhe gjuhës së thjeshtë, si dhe ndihmën në marrëdhëniet e personit me palë të treta, që nuk mund të kuptojnë mënyrat e tij të komunikimit. Mbështetja jepet gradualisht, duke u dhënë kohë të mjaftueshme personave që e kërkojnë atë, për të mësuar se si mund ta përdorin mbështetjen për më të mirën e tyre.

- rezultatet që individi me aftësi të kufizuara synon të arrijë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve;
- shërbimet që mund nevojiten për të arritur rezultatet;
- të drejtat dhe përgjegjësitë e individit dhe ofruesit të shërbimit;
- periudhën kohore që do të mbulohet plani individual; dhe
- çdo çështje tjetër të rëndësishme për individin për të arritur rezultate.

KONTEKSTI

Qëllimi i kësaj kornize është të ofrojë mbështetje në zhvillimin e PMI-ve për personat me aftësi të kufizuara, për të siguruar që këta persona të përjetojnë qëndrueshmëri gjatë planifikimit dhe zhvillimit të planeve individuale, si dhe zbatimit të këtyre planeve.

Me kalimin në Skemën e Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar është gjithnjë e më e rëndësishme të zhvillohen plane individuale që kanë të bëjnë me vetëvendosjen, zgjedhjen dhe angazhimin e komunitetit; si dhe mbrojtjen e të drejtave të individit, duke qenë se kjo skemë e re vlerësimi ka qasje bazuar në të drejtat e njeriut.

Ky dokument do të shërbejë si një guidë për stafin që do të bëjë planifikimin, për:

- t'i ardhur në ndihmë personave me aftësi të kufizuar për të drejtuar planifikimin dhe për të bërë zgjedhjet e tyre për mënyrën se si dëshirojnë të jetojnë jetën e tyre;
- të ndihmuar personat me aftësi të kufizuar për të identifikuar qëllimet, aspiratat dhe nevojat e tyre, si dhe mbështetjen e nevojshme;
- respektimin dhe mbështetjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të inkurajuar zgjedhjen, zhvillimin e aftësive dhe mundësinë për të komunikuar nevojat;
- të ofruar informacion, mundësi dhe mbështetje për të lejuar personin me aftësi të kufizuar të bëjë zgjedhje të informuara;
- të mundësuar planifikimin e fokusuar në familje që respekton dhe merr parasysh rolin e secilit individ;
- të të qenë të ndjeshëm ndaj orientimit kulturor, fetar dhe gjinor të personit me aftësi të kufizuar;
- të siguruar zbatim fleksibël dhe të përgjegjshëm.

PMI është kërkesë e legjislacionit në fuqi², i cili ka përcaktuar edhe kërkesat e përmbajtjes, kushtet e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

² Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”; VKM Nr. 436, datë 22.6.2022 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe të kritereve të ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara”; VKM Nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, të ndryshuar.

PARIMET DREJTUESE

Parimet që duhet të udhëheqin procesin e hartimit të PMI-ve janë:

Parimi i vendosjes së individit në qendër (qendërzimi i PAK)

PMI-të vendosin personat me aftësi të kufizuara në qendër të planifikimit dhe maksimizojnë sa më shumë që të jetë e mundur kapacitetin e tyre për të marrë kontrollin e jetës. Aty ku është e nevojshme, merret parasysh dhe respektohet roli i familjes dhe personave të tjerë që janë të rëndësishëm në jetën e individit.

Rezultatet individuale

PMI-të bazohen në pikat e forta individuale dhe pasqyrojnë nevojat, interesat, synimet, rrjetet e mbështetjes formale dhe joformale. Çdo individ sjell atributet e veta unike kur shqyrton përcaktimin e qëllimeve, duke përfshirë moshën e personit me aftësi të kufizuara; rrethanat e tyre aktuale; bindjet dhe vlerat personale. Është e rëndësishme që këta faktorë të merren parasysh kur vendosen qëllimet dhe rezultatet në përputhje me nevojat dhe dëshirat individuale të personit.

Planet individuale përfshijnë, sipas rastit, medikamentet dhe menaxhimin financiar së bashku me planet e mbështetjes së sjelljes.

Vendimmarrja dhe dhënia e pëlqimit

Individët inkurajohen dhe mbështeten që të përfshihen në vendimmarrje dhe planifikim sa më shumë që të jetë e mundur sipas kapacitetit të tyre. Të gjitha PMI-të duhet të negociohen me individin ose me një person të emëruar nga personi me aftësi të kufizuara.

Maksimizimi i zgjedhjes dhe kontrollit

PMI-të duhet të mbështesin të drejtën e personit me aftësi të kufizuara për të ushtruar kontroll mbi jetën e tyre dhe për të maksimizuar zgjedhjen dhe pavarësinë.

Zhvillimi i PMI-ve cilësore

Zhvillimi i PMI-ve cilësore kërkon kohë dhe shqyrtim të kujdesshëm të përmbajtjes për të vënë në dukje rëndësinë e:

- promovimit të roleve të çmuara për personat me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe private;
- lidhje tme familjen, miqtë dhe komunitetet e zgjedhura;
- pjesëmarrjen ekonomike dhe komunitare dhe përfitimet shoqëruese për individin dhe komunitetin më të gjerë;
- pjesëmarrjen e bazuar në interesat, identitetin, trashëgiminë, preferencat, synimet dhe aspiratat e një individi (të cilat mund të ndryshojnë me kalimin e kohës); dhe
- rolin e familjes, miqve, kujdestarëve, avokatëve dhe organizatave të tjera në promovimin e pjesëmarrjes dhe përfshirjes.

Planifikimi individual ndërmerret në përputhje me politikat dhe procedurat e legjislacionit në fuqi

Këto politika dhe procedura do të sigurojnë që PMI-të të zhvillohen dhe rishikohen brenda afateve të arsyeshme kohore.

Politikat dhe procedurat në fuqi në lidhje me planifikimin individual janë lehtësisht të disponueshme për të gjithë stafin, individët dhe të tjerët të përfshirë në mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm

Të gjitha palët e përfshira në procesin e planifikimit individual duke përfshirë individët me aftësi të kufizuara, familjet e tyre, shërbimet e aftësisë së kufizuar kanë përgjegjësinë të reflektojnë mbi praktikën aktuale, të njohin kur dhe ku ekzistojnë problemet, të identifikojnë faktorët që kontribuojnë në ato probleme, të inicojnë ndërhyrje dhe të vlerësojnë rezultatin e ndërhyrjeve për të përmirësuar praktikën. Të gjitha palët janë gjithashtu përgjegjëse për të konsideruar se kur një PMI mund të ketë nevojë për përditësim.

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E AKTORËVE

Të gjitha palët duhet të punojnë në bashkëpunim për të siguruar zhvillimin e duhur dhe efektiv, zbatimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të PMI-ve në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi

Personi me aftësi të kufizuar:

- duhet të angazhohet në mënyrë aktive në vendimmarrje sa më shumë që të jetë e mundur;
- mund të ketë nivele të ndryshme të aftësisë së kufizuar (e lehtë, moderuar, rëndë dhe thellë) dhe aftësisë për të marrë vendime, prandaj është e rëndësishme të merren në konsideratë
 - ✓ faktorët që ndikojnë në aftësinë e individit për t'u angazhuar p.sh. koha, mjedisi, njerëzit e përfshirë;
 - ✓ aftësia për të dhënë pëlqimin për marrjen e vendimeve dhe me kë të diskutojë planifikimin në rast se individ nuk është në gjendje të japë pëlqimin p.sh. person përgjegjës, kujdestar ligjor, i afërm
 - ✓ stili i komunikimit p.sh. përdorimi i mbështetësve pamor, niveli i leximit
 - ✓ kapaciteti fizik p.sh. dëmtimi i shikimit, dëmtimi i dëgjimit
- duhet të punojnë në partneritet me ata që i mbështesin dhe të kërkojnë ndihmë për të zgjidhur problemet kur ato lindin dhe
- mund të mbështetet gjatë procesit nga një person i zgjedhur prej tij.

Personi i zgjedhur:

- mund të marrë vendime në interesin më të mirë të personit me aftësi të kufizuara;
- siguron që dëshirat e personit të komunikohen dhe të respektohen sa më shumë; dhe
- bashkëpunon me individin, profesionistët dhe rrjete të tjera mbështetëse për të siguruar që qëllimet e individëve respektohen vazhdimisht.

Ofruesi i shërbimit:

- sigurohet që të ketë një kuptim të përbashkët të qëllimeve ndërmjet individit dhe ofruesit të shërbimit përpara se individ të fillojë aksesin e rregullt në shërbim;
- krijon një draft version të PMI-së;
- zhvillon plane për individët ekzistues që nuk e kanë një të tillë në standardin e kërkuar;
- bashkëpunon me individin dhe palët e tjera për të arritur qëllimet e PMI-së;
- kërkon në mënyrë aktive të kuptojë nevojat e individit;
- shfrytëzon në mënyrë efektive burimet e disponueshme;
- rishikon planet çdo 12 muaj ose më shpesh nëse ka një ndryshim të rëndësishëm në rrethanat e individit.

Gjatë zhvillimit të planit është e rëndësishme të vendoset se kush do të jetë përgjegjës për zbatimin dhe rishikimin, veçanërisht kur ka më shumë se një ofrues shërbimi të përfshirë. Bashkëpunimi ndërmjet ofruesve do të mundësojë shkëmbimin e njohurive, ideve dhe ekspertizës; si dhe mbështetje të shtuar për të lejuar individin të arrijë qëllimet e tij.

Nëse një individ nuk dëshiron të ketë një PMI ai duhet të informohet paraprakisht se sipas legjislacionit në fuqi përmes PMI-së synohet ofrimi i mbështetjes së vazhdueshme për aftësinë e kufizuar dhe lloji i mbështetjes që ofrohet;

Nëse një individ akseson më shumë se një shërbim, personi duhet të pyetet nëse dëshiron që secili shërbim të zhvillojë dhe të mbajë planet e veta individuale ose nëse individ do të preferonte që një plan të përfshijë të gjithë mbështetjen dhe qëllimet e shërbimit. Në rastin e të paturit të një plani për të gjitha shërbimet, duhet të siguroheni që rishikimet të kryhen me pjesëmarrjen e të gjithë ofruesve të shërbimeve.

Nëse një person refuzon të përfshihet në zhvillimin e një plani, dokumentojeni këtë së bashku me arsyen e dhënë. Zhvilloni një plan të bazuar në planifikimin e mëparshëm, njohuritë e personit dhe kërkesat e mbështetjes së përditshme. Jepini një kopje të PMI-së personit në një të aksesueshëm dhe ofrojini mundësi të vazhdueshme për rishikimin e tij.

PLANI I MBËSHTETJES INDIVIDUALE

PMI është një dokument që hartohet midis një individi, mbështetësve të tij dhe një ofruesi shërbimi që pasqyron qëllimet e personit me aftësi të kufizuara, përshkruan se si do të ofrohet mbështetje për të adresuar dhe arritur qëllimet e tyre dhe si do të maten rezultatet.

Qëllimet e vendosura në PMI janë ide rreth asaj që një person me aftësi të kufizuara do të dëshironte të bënte ose të arrinte – ato mund të jenë të mëdha ose të vogla dhe mbulojnë shumë aspekte të jetës së këtij personi. Vendosja e qëllimeve i ndihmon personat me aftësi të kufizuara të punojnë drejt gjërave që janë më të rëndësishme për ta dhe të ndryshojnë ato gjëra me të cilat nuk janë të kënaqur.

Një PMI përmban³:

- Të dhënat personale për personin me aftësi të kufizuara;
- Të dhënat mbi gjendjen shëndetësore dhe aftësinë e kufizuara;
- Të dhëna mbi arsimimin dhe punësimin;
- Të dhënat mbi nevojat për mbështetje;
- Objektivat individuale;
- Aktivitetet dhe rezultatet e pritshme;
- Të dhëna mbi personat që kontribuan në bashkëhartimin e planit.

Hartimi i PMI-ve ofron një mundësi për diskutim të hapur për të identifikuar dhe eksploruar risqet ekzistuese dhe të mundshme për një person me aftësi të kufizuara. Individët duhet të mbështeten që të marrin në konsideratë një sërë masash mbrojtëse dhe mekanizmash mbështetës kur zhvillojnë planet e tyre, përcaktojnë kërkesat e tyre për mbështetje dhe zbatojnë planet e tyre.

Mbështetja duhet të identifikohet në një plan, në mënyrë që ata që përfshihen në zbatimin e tij të dinë rolin e tyre dhe çfarë kërkohet. Është e rëndësishme të merret parasysh nëse personi me aftësi të kufizuara ka ndonjë preferencë për mënyrat e mbështetjes. Konteksti mjedisor dhe personal i rregullimeve të jetesës së individit, mbështetjet joformale dhe të tjera të komunitetit dhe pjesëmarrja sociale dhe ekonomike, luajnë një rol jetik në mënyrën se si ata jetojnë jetën e tyre dhe do të ndihmojnë në informimin e qëllimeve të tyre.

Mbështetja joformale janë mbështetje që ofrohen nga ndihmësit personalë, familja, miqtë, etj. Mbështetja kryesore dhe e komunitetit është e disponueshme për të gjithë anëtarët e komunitetit, pavarësisht nëse ata kanë aftësi të kufizuara ose jo, p.sh., mbështetja e ofruar nëpërmjet sistemeve të shëndetësisë, arsimit, transportit, etj.

Gjatë hartimit të PMI-së për fëmijët nën 16 vjeç është e rëndësishme të diskutohen aftësitë e vetëvendosjes, sociale dhe të tjera. Gjthashtu, duhen eksploruar interesat dhe aftësitë e fëmijëve

³ Shih Aneksin nr. 1. Plani i Mbështetjes Individuale (PMI)

dhe të kuptuarit e roleve të të rriturve. Pavarësisht, Planeve Individuale të Arsimimit, ndihmojini ata të mësojnë mbi mundësitë e punës dhe karrierës, vullnetarizmit dhe shërbimit në komunitet. Ndihmojini ata për të zhvilluar, përmirësuar dhe praktikuar aftësitë për jetesë të pavarur. Për grupmoshën mbi 16 vjeç, përveç sa më sipër, nevojitet të identifikohen paraprakisht programet e mbështetjes së komunitetit për rehabilitimin profesional dhe jetesën e pavarur, për tu siguruar që në PMI janë bërë referimet e duhura.

Për të ndihmuar një person me aftësi të kufizuar për të arritur qëllimet e tij, është e rëndësishme:

- ✓ të merrni parasysh mbështetjen joformale që është natyrshëm e pranishme në jetën e personit me aftësi të kufizuar;
- ✓ të mos nënvlerësoni sa shumë mund të bëjë personi me aftësi të kufizuar për veten e tij;
- ✓ disa plane kanë shumë mbështetje;
- ✓ PMI të ndërtohet mbi mbështetjen dhe burimet e disponueshme për personin me aftësi të kufizuar.

Rezultatet ndihmojnë në identifikimin e "suksesit" për një person me aftësi të kufizuar dhe për t'u siguruar që ata janë në rrugën e duhur për të arritur qëllimet e tyre. Rezultatet ndihmojnë ata që janë përgjegjës për zbatimin e PMI-së për të monitoruar dhe rishikuar suksesin e tij. Rezultatet dhe mënyra se si do të matet progresi drejt këtyre rezultateve duhet të diskutohen dhe bien dakord gjatë procesit të planifikimit. Kjo duhet të përfshijë caktimin e një date rishikimi.

RISHIKIMI, MONITORIMI, VLERËSIMI DHE PËRFUNDIMI I PMI

PMI nevojitet të rishikohet të paktën një herë në 12 muaj, vecanërisht për personat me aftësi të kufizuar që jetojnë në një mjedis banimi. Rishikimi i planeve individuale çdo 12 muaj, konsiderohet praktika më e mirë, veçanërisht kur personi me aftësi të kufizuar ka një paketë mbështetëse individuale financiare në baza vjetore (nga komisioni i vlerësimit të aftësisë së kufizuar). Data e rishikimit duhet të përcaktohet gjatë hartimit të planit fillestar individual.

Vetë personi me aftësi të kufizuar ose personi përgjegjës i tij mund të kërkojë rishikim të PMI-së në çdo kohë. Ndryshimet duhet t'u komunikohen të gjitha palëve – individit, personit përgjegjës (nëse është relevant) dhe të gjithë ofruesve të shërbimeve të përfshirë.

Të gjitha palët janë përgjegjëse për zbatimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të PMI-së. Secila palë është përgjegjëse për monitorimin e aktiviteteve. Një rishikim i një PMI-e është i nevojshëm nëse:

- ✓ nevojat e individit ndryshojnë p.sh. përkeqësimi fizik, ndryshimi i akomodimit
- ✓ objektivat arrihen ose ndryshojnë
- ✓ strategjitë janë joefektive
- ✓ ndryshim në përfitimet, mbështetjen ose ofruesit e shërbimeve

Ndërprerja e një PMI-e mund të ndodhë vetëm kur një individ pushon së marri mbështetje të vazhdueshme për aftësinë e kufizuar.

Aneks 1

PLANI I MBËSHTETJES INDIVIDUALE

I. Të dhëna personale për personin me aftësi të kufizuar

Emri, atësia, mbiemri _____

Datëlindja _____

Vendlindja _____

Gjinia _____

Numri ID _____

Adresa _____

II. Të dhëna mbi gjendjen shëndetësore dhe aftësinë e kufizuar

Diagnoza kryesore	
Diagnoza të tjera	
Ofruesi i shërbimit shëndetësor ⁴	
Shpeshtësia e marrjes së shërbimit shëndetësor ⁵	
Lloji i aftësisë së kufizuar	
Niveli aftësisë së kufizuar	

⁴ Jepni të dhëna mbi institucionin shëndetësor ku merr shërbim personi.

⁵ Jepni të dhëna mbi frekuencën e marrjes së shërbimit, psh. sa shpesh merr shërbim tek mjeku i familjes dhe/ose specialist.

III. Të dhëna mbi arsimimin dhe punësimin⁶

Cerdhe/Kopësht	
Arsimi bazë	
Arsimi i mesëm i ulët	
Arsim i mesëm i lartë	
Arsim i lartë ⁷	
Doktoratë / Titull Akademik	
Kurse kualifikimi	
Punëkërkuar i papunë	
I punësuar	
I vetëpunësuar	
Tjetër (specifiko)	

IV. Të dhëna mbi mbështetjen

Lloji i mbështetjes	Po / Jo	Nevojat ⁸	Lloji i shërbimit ⁹	Subjekti ¹⁰
Kujdestar Ligjor				
Ndihmës Personal				
Përkthyes të gjuhës së shenjave				
Shërbime ¹¹				
Pajisje / mjete ndihmëse				

⁶ Shëno të dhëna të detajuara mbi arsimin që ndjek apo ka ndjekur, vitin akademik, kohëzgjatjen, institucionin arsimor ku studion, etj; Të dhëna mbi punësimin, institucionin / subjektin ku është punësuar / vetëpunësuar, forma të tjera punësimi, etj.

⁷ Specifiko ciklin (i parë / i dytë / i tretë)

⁸ Jepni të dhëna mbi nevojat për mbështetje duke përcaktuar edhe fushat ku ka nevojë për mbështetje.

⁹ Jepni sa më shumë të dhëna mbi llojin e përfitimit, (shërbime sociale, mjete ndihmëse, karrige me rrota, proteza, etj.

¹⁰ Jepni të dhëna mbi ofruesin e shërbimit, vendndodhjen dhe kontaktet.

¹¹ Shërbime aftësuese, integruuese, rehabilituese, etj.

V. Objektivat individuale¹²

Objektivi / Qëllimi / Dëshira	Afati kohor ¹³	Aftësitë individuale ¹⁴	Burimet ¹⁵	Komuniteti ¹⁶

VI. Aktivitetet dhe rezultatet e pritshme

Aktiviteti ¹⁷	Rezultati ¹⁸	Personi përgjegjës	Afati kohor
1.1			
1.2.....			
2.1.....			
2.2.....			

¹² Jepni të dhëna mbi objektivat individuale afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të personit me aftësi të kufizuar, përfshirë edhe dëshirat e tyre si: shkollimi, argëtimi, sportet, arti, punësimi, etj.

¹³ Afatshkurtër / afatmesëm / afatgjatë

¹⁴ Vendos aftësitë individuale të personit me aftësi të kufizuar për arritjen e objektivave të tij.

¹⁵ Shëno burimet që mund të ndihmojnë në realizimin e objektivave të personit me aftësi të kufizuar (miq, shokë, të aftërm, familjarë, etj).

¹⁶ Shëno burimet gjithëpërfshirëse të komunitetit që mund të përdoren për arritjen e objektivave (kopshte, shkolla, qendra të formimit profesional, qendra punësimi, palestra, biblioteka, klube shoqërore, organizata sportive, politike, të avokatisë, etj).

¹⁷ Çdo aktivitet lidhet me një objektiv. Për çdo objektiv mund të parashikohen 1 apo më shumë aktivitete, në varësi të objektivit.

¹⁸ Për cdo aktivitet duhet të ketë një rezultat të pritshëm.

VII. Bashkëhartuesit e planit

Emri, mbiemri	Funksioni/lidhja me personin me aftësi të kufizuara	Dakordësia me përcaktimet në këtë plan (po/jo)	Nënshkrimi	Data

Periudha e rishikimit të Planit ____/____/____

Plani u përgatit nga:

Emri, Mbiemri _____, Funksioni _____

Nënshkrimi _____ Data _____

Bibliografia

Konventa e OKB “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar”

Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;

VKM Nr. 436, datë 22.6.2022 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe të kritereve të ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara”;

VKM Nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, të ndryshuar;